



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 gusht 2022
Nr. ref.:AGJ 2040/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI10/22

Parashtrues

Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, ARJ.nr. 115/2021, të 18 nëntorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, të cilën e përfaqëson Bedri Zhegrova (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ.nr. 115/2021] e 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [AA.nr.651/2021] e 6 gushtit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (Në tekstin në vijim: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 janar 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata).
6. Më 27 janar 2022, parashtruesi i kërkesës plotësoi kërkesën e tij duke kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme lidhur me vendimin e kontestuar.
7. Më 3 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 15 shkurt 2022, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ta që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, ta plotësojë dosjen duke plotësuar formularin e kërkesës.
9. Më 15 shkurt 2022, Gjykata njoftoi (i) Gjykatën Supreme, (ii) Kryeministrin e Kosovës; (iii) Ministren e Drejtësisë; dhe (iv) Avokatin e Popullit, për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtëve i ofroi një kopje të kërkesës.
10. Më 4 mars 2022, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë *“Opinionin e Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit A.nr. 1430/21, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Aktvendimit AA.nr. 651/2021, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin ARJ nr. 115/2021, i Gjykatës Supreme, të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore.”*
11. Më 8 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.

12. Më 4 prill 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
13. Më 9 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe kërkoi plotësimin e lëndës.
14. Më 18 korrik 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
15. Të njëjtën ditë, Kryetarja Gresa Caka Nimani u deklarua se do të paraqes mendim konkurrues në pajtim me rregullin 62 (1) të Rregullores së Punës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 3 korrik 2020, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ishte publikuar Rregullorja MD-Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore (në tekstin në vijim: Rregullorja e IML-së), e cila në nenin 29 (Hyrja në fuqi) përcaktonte që kjo Rregullore hyn në fuqi gjashtë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, përkatësisht me 3 janar 2021.
17. Rregullorja e IML-së në preambulën e saj, si bazë ligjore e kishte nenin 16 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, i cili përcaktonte që organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Institutit, rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri i Drejtësisë në pajtim me Ligjin për administratë shtetërore.
18. Më 30 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar padi për fillimin e konfliktit administrativ ku kërkonte nga Gjykata Themelore që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të nxjerrë aktgjykim me të cilin do e shpallte të kundërligjshëm Rregulloren e IML-së.
19. Më 5 korrik 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A.nr.1430/21] hodhi poshtë si të palejuar padinë e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore theksoi si në vijim:

“Prandaj, marr parasysh referimet ligjore të cekura si më lartë, del se ‘Rregullorja nr.01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e IML’- anulimi i të cilës kërkohet nga paditësja me këtë padi, nuk paraqet akt përfundimtar administrativ në kuptimi të nenit 3 paragrafi 1.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe në kuptimi të nenit 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 me të cilat dispozita është përcaktuar struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ. Po ashtu Rregullorja në fjalë nuk paraqet akt administrativ mbi bazën e së cilës mund të iniciohet konflikti administrative dhe të sigurohet mbrojtja gjyqësore në kuptim të nenit 2 dhe 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Prandaj, gjykata në kuptim të nenit 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padinë e paditësit e hudhi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që akti që kontestohet me padi nuk paraqet akt administrativ.”

20. Më 19 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ dhe procedurës kontestimore, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset, dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

21. Më 6 gusht 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA.nr.651/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin [A.nr.1430/2021] e 05 korrikut 2021, të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi si në vijim:

“Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak se gjykata e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për hedhjen poshtë si të palejuar të padisë së paditësit. Andaj, në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura me ankesë, për shkak se Rregullorja nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), nuk është akt përfundimtar në procedurë administrative.”

22. Më 29 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës paraqet kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, me propozimin që kërkesa të aprovohet në tërësi si e bazuar si dhe të anulohen Aktvendimi i Gjykatës Themelore dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit dhe lënda ti kthehet Gjykatës Themelore në rigjykim.

23. Më 18 nëntor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [ARJ.nr. 115/2021] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Në Arsyetimin e këtij Aktvendimi, Gjykata Supreme theksoi si në vijim:

“Nga dispozitat e cituara si më lartë dhe sipas gjendjes së vërtetuar nga gjykatat e instancave më të ulëta kolegji vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me hedhjen e padisë së paditësit si të palejueshme sepse nuk është kontestuese se akti Rregullorja nr. 01/2020, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e IMJ, nuk është akt përfundimtar i nxjerrë në procedurë administrative ndaj të cilit mund të bëhet vlerësimi i Ligjshmërisë së tij në procedurë gjyqësore, ashtu si parashihet me dispozitat e cituara si më lartë të LKA-së dhe LPA-së. Me shqyrtimin e kësaj çështje në procedurë gjyqësore do të tejkalohet kompetenca e gjykatës sepse akti i kontestuar nuk është akt i nxjerrë në formë të vendimit në fund të një procedure administrative të vendosjes me vendim përfundimtar ndaj të cilit do të mund të fillonte konflikti administrativ nga personi fizik apo juridik nëse vlerëson se i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor.”

24. Më 30 nëntor 2021, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatën Supreme Opinionin lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar në Gjykatën Supreme (ARJ.nr.115/2021) nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ku theksonte se “çështja e përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjet bazike paraqet një çështje ligjore dhe se në këto rrethana do të duhej të vlerësohej ligjshmëria e akteve nënligjore.”

25. Më 4 mars 2022, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë: “Opinionin e Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën KI 10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [A.nr. 1430/21] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të Aktvendimit [AA.nr. 651/2021] të Gjykatës së Apelit dhe të Aktgjykimit [ARJ. nr. 115/2021] të Gjykatës Supreme.”

Opinionin e Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën KI10/22 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore

26. Fillimisht Avokati i Popullit thekson se parashtuesi i kërkesës kishte parashtuar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e ngritur në Gjykatën Supreme për rishikimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.
27. Në vijim, Avokati i Popullit thekson se në rrethanat e rastit konkret kemi të bëjmë me një kërkesë nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e ligjshmërisë së një rregulloreje në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës.
28. Më tej Avokati i Popullit vëren se kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së është refuzuar si e pabazuar nga Gjykatat e rregullta, duke e bërë të paqartë se cili institucion është përgjegjës për vlerësimin e akteve nënligjore apo nëse rregulloret e brendshme konsiderohen akte të përgjithshme, të cilat mund t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.
29. Në vijim, Avokati i Popullit thekson se në vazhdimësi pranon ankesa nëpërmjet të cilave i kërkohet paraqitja e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore (udhëzimeve administrative, rregulloreve), të miratuara nga organet e administratës shtetërore apo publike.
30. Avokati i Popullit gjithashtu shpreh qëndrimin lidhur me mjetet juridike për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së rregulloreve të brendshme të institucioneve, mbeten të vendosen nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa çështja e vlerësimit të ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së udhëzimeve administrative nuk qartësohet krejtësisht me Ligjin Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Për më shumë, praktika e gjykatave të rregullta, konkretisht Aktvendimi [A.m.2886/2019] i 11 qershorit 2020, të Gjykatës Themelore [rast i cili ishte dorëzuar në Institucionin e Avokatit të Popullit nga shoqata e Distributorëve Farmaceutikë] sipas të cilit kundër udhëzimit administrativ nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ dhe se për çështjen në fjalë ishte siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, "[...] pa dhënë ndonjë sqarim se cila është mbrojtja gjyqësore e siguruar jashtë konfliktit administrativ, krijon një situatë të paqartë juridike, e cila kërkon një zgjidhje që do t'u mundësonte qytetarëve përdorimin efikas të mjeteve juridike."
31. Avokati i Popullit konsideron se është shumë me rëndësi të sqarohet përgjegjësia e institucionit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore. Kjo do të mundësonte vlerësimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, por edhe realizimin e së drejtës kushtetuese, përkatësisht nenet 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike].
32. Përfundimisht, Avokati i Popullit konsideron se situatat e tilla do duhej të përcaktoheshin qartë në dispozitat e ligjeve (Ligjit për Aktet Normative, i cili aktualisht është në shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, dhe Ligjin për Konfliktet Administrative, i cili është në fazën e draftimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike). Rrjedhimisht, kjo do të krijonte pasqyrë të qartë se cilat janë akte të përgjithshme normative, cilat nga këto akte i nënshtrohen kontrollit gjyqësor e cilat jo dhe të përcaktohej kompetenca e organit kompetent për vlerësimin e ligjshmërisë/kushtetutshmërisë së akteve të tilla. Prandaj Avokati i Popullit e vlerëson si të domosdoshëm vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjet në fjalë e që drejtpërsëdrejti kanë ndikim në të drejtën për mbrojtje gjyqësore dhe për mjete juridike.

Pretendimet e parashtuesit të kërkesës

33. Parashtuesi i kërkesës pretendon se Vendimi i kontestuar, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim

të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

34. Parashtruesi i kërkesës thekson se refuzimi nga secili nivel gjyqësor për ta vlerësuar çështjen e vlerësimit në merita të ligjshmërisë së Rregullores së IML-së, ua ka pamundësuar realizimin e një të drejte të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës. Pra, sipas parashtruesit të kërkesës, atyre po iu pamundësohet mbrojtja e të drejtave të tyre nga gjykatat, të cilat janë shkelur me Rregulloren e IML-së.
35. Në këtë vijë argumentimi, parashtruesit e kërkesës theksojnë se është detyrë e gjykatave që të vlerësojnë përputhshmërinë me ligj të akteve që janë me fuqi nënligjore. Përmes kësaj vjen deri tek mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe realizohet kontrolli gjyqësor i veprimeve administrative. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, aktet nënligjore mbesin me fuqinë më të lartë juridike, madje me fuqi edhe më të lartë se ligjet, për shkak se sipas tyre *“nuk ekziston një institucion në Republikën e Kosovës i cili do vlerësonte ligjshmërinë e tyre, dhe eventualisht anulimin e tyre nëse vlerëson kundërligjshmërinë e tyre akteve.”*
36. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se veprimet e tilla të gjykatave përveç shkeljes së dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me mbrojtje gjyqësore të të drejtave, për më tepër ato bien ndesh edhe me Ligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat, përkatësisht nenin 4 (Pavarësia dhe Paanësia e Gjykatave) e cila përcakton që *“Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.”* Pra, parashtruesi i kërkesës e rithekson qëndrimin e saj që gjykatat duhet të vlerësojnë përputhjen e akteve nënligjore me ligjet, nga të cilat kanë derivuar, pasi që në të kundërtën parimi i ligjshmërisë në Kosovë do jetë vetëm *“imagjinar”*.
37. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, pretendohet që refuzimi i vazhdueshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së prodhon joefektivitet të mjeteve juridike. Prandaj, refuzimet e tilla nga gjykatat e cenojnë direkt dispozitën kushtetuese të të drejtës për mjete juridike. Edhe në këtë rast ngjashëm sikurse në rastin e mësipërm veprimi i gjykatave është në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për mjete juridike, sepse u pamundëson individëve që ti përdorin mjetet juridike sepse refuzojnë shqyrtimin e tyre.
38. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar i janë cenuar të drejtat kushtetuese lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të përcaktuar në nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.
39. Parashtruesi i kërkesës thekson se duke pasur parasysh faktin se akti i kontestuar në gjykatat e rregulla është Rregullorja e IML-së, e cila praktikisht prodhon pasoja të pariparueshme për personelin punonjës në IML, dhe vazhdimisht prodhon shkelje për personelin punonjës në IML, të njëjtit kërkojnë nga Gjykata që të nxjerr masë të përkohshme e cila do e pezullojë zbatimin e këtij akti të kontestuar deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.
40. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktvendimi [A.nr. 1430/21] i Gjykatës Themelore, Aktvendimi [AA.nr. 651/2021] i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi [ARJ nr.115/202] i Gjykatës Supreme, nuk janë në pajtim me nenin 32 [E Drejta për mjete juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës dhe të njëjtat ti anuloj si kundërkushtetuese; (iii) Të obligojë Gjykatën Supreme që ti anulojë Aktvendimin

[A.nr. 1430/21] e Gjykatës Themelore, Aktvendimin [AA.nr. 651/2021] e Gjykatës së Apelit dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe të vendosin në *meritum* për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së; (iv) ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese për veprimet e ndërmarra, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

[...]

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Ligji për Konfliktet Administrative

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.

Neni 3 Përkufizimet

- 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:*

1.1 Organ - organet e administratës publike, organet e qeverisjes qendrore dhe organet e tjera në varësi të tyre, organet e vetëqeverisjes lokale dhe organet në varësi të tyre, kur në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin në çështjet administrative.

1.2. Akt administrativ - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.

1.3. Çështja administrative - sipas këtij ligji është situata e veçantë e pakontestueshme e me interes publik, në të cilën drejtpërdrejt nga dispozitat juridike, rezulton nevoja që sjellja e ardhshme e palës, të përcaktohet në mënyrë juridike –autoritative.

Neni 9

Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.

Neni 10

1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.

2. Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.

3. Organi ka të drejtë të iniciojë konfliktin administrativ, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, nëse ai/ajo konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij.

4. Nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në favor të personit fizik, personit juridik, konfliktin mund ta iniciojë prokurori publik kompetent ose organi tjetër i autorizuar me ligj. Organet e administratës kanë për detyrë që, kur të kenë mësuar për to, të njoftojnë prokurorin publik kompetent ose organin e autorizuar me ligj.

5. Konfliktin administrativ mund ta iniciojë edhe prokurori publik kompetent ose personi i autorizuar nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në dëm të organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të tjera në varësi të tyre, të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të organeve në varësi të tyre, kur janë shkelur të drejtat pronësore të këtyre organeve.

Neni 13

Konflikti administrativ

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.

2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

Neni 14

Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.

Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 47

Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar

1. Akti administrativ i shkruar përmban:

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin);

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjal.

3. Kërkesa e nënshkrimit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik duhet të bazohet në një certifikatë të kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik përkatës.

4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me vendim të posaçëm, mund të përcaktojë një mënyrë tjetër të sigurt, që garanton autenticitetin dhe integritetin e dokumentit elektronik të dërguar dhe veçantitë e tij. Një dokument elektronik i garantuar në pajtim me një vendim të tillë të Qeverisë, do të vlerësohet, gjithashtu, si i nënshkruar.

Neni 48

Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

- 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;*
 - 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;*
 - 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;*
 - 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;*
 - 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;*
 - 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.*
- 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

LIGJI Nr. 04/-L-011 PËR ORGANIZIMIN SINDIKAL NË KOSOVË

Neni 15

E drejta e sindikatës pas regjistrimit

- 1. Pas regjistrimit, sindikata ka të drejtë:*
- 1.1. t'i gëzojë të gjitha të drejtat e një personi juridik, në pajtim me dispozitat ligjore;*
- 1.2. t'i përfaqësojë anëtarët e vet para punëdhënësve dhe autoriteteve publike në lidhje me çdo çështje që përfshin negociatat kolektive për të punësuarit, veçmas në avancimin e dialogut social, të drejtave ekonomike e sociale, nga marrëdhënia e punës;*
- 1.3. t'i administrojë mjetet e saj për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarëve.*

Neni 16

Legjitimiteti sindikal

- 1. Sindikata e regjistruar do të ketë cilësinë e personit juridik, me të drejtat dhe detyrat e caktuara me ligj, Statutin e Sindikatës dhe Konventat Ndërkombëtare të ONP-së.*
- 2. Sindikata duhet të ketë llogon e saj e cila do të jetë e graviruar në vulë dhe është e ndaluar të përdoret nga sindikatat e tjera.*
- 3. Sindikatën e përfaqëson kryetari i Sindikatës.*
- 4. Sindikata duhet të ketë konton bankare me autorizim, për financimin e veprimtarisë sindikale.*

Neni 30

Mbrojtja e anëtarëve sindikal në Gjykatë

Çdo organizatë sindikale e njohur si person juridik, mund t'i drejtohet Gjykatës për mbrojtjen e interesave të secilit prej anëtarëve të saj, për të obliguar punëdhënësin që të veprojë sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
42. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[...]

4. *Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*

Neni 113

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

43. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik."

[...]

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

44. Fillimisht, çështjen e legjitimitetit, Gjykata e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Gjykata sqaron se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës, në cilësi të sindikatës të IML-së, përkatësisht si person juridik, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj, që vlejnjë për individët dhe personat juridikë (shih rastet e Gjykatës, KI10/20, me parashtues *“Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” SH. A. – Njësia Malësia e Re Prizren*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 tetorit 2020, paragrafi 35; rasti KI41/09, parashtuesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
45. Në mbështetje të argumentimit të mësipërm, Gjykata duke u referuar edhe në praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) vëren se sipas ligjit kombëtar sindikatave duhet tu mundësohet, në kushte që nuk janë në kundërshtim me nenin 11 të Konventës, të përpiqen për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të tyre (shih rastin e GJEDNJ-së: *Sindicatul “Păstorul cel Bun” kundër Rumanisë*, nr. 2330/09, Aktgjykim i 9 korrikut 2013, paragrafi 134). Togfjalëshi *“për mbrojtjen e interesave të tij”* nuk mund të interpretohet se nënkupton që vetëm individët dhe jo sindikatat mund të bëjnë ankesë sipas kësaj dispozite (shih rastin e GJEDNJ-së: *Federata e Sindikatave të Punëtorëve të Offshore dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, nr. 38190/97, Vendim i 27 qershorit 2002). Rrjedhimisht, Neni 11 i Konventës mbron si punëtorët ashtu edhe sindikatat (shih rastin e GJEDNJ-së: *Federata e Sindikatave Republikane Yakut kundër Rusisë*, nr. 29582/09, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2021, paragrafi 30).
46. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson që parashtuesi i kërkesës (Sindikata e IML-së) në cilësi të personit juridik, e regjistruar në bazë të ligjit për organizimin Sindikal, si dhe bazuar në nenin 10 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka legjitimitet që të mbrojë interesat e anëtarëve të vet para gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, parashtuesit e kërkesës kanë provuar që interesi i tyre konsiston në të konstatuarit që Rregullorja e IML-së, nuk është në pajtueshmëri me premiset e strukturës organizative të IML-së, të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore.
47. Në vijim, sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme procedurale, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.115/2021] të 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
48. Në fund dhe pas shqyrtimit të ankesës kushtetuese të parashtuesit të kërkesës, Gjykata konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës. Gjykata vëren se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me mos dhënien e mbrojtjes adekuate gjyqësore nga gjykatat e rregullta, si pasojë e mos-shqyrtimit në merita të çështjes së vlerësimit të ligjshmërisë së Rregullores së IML-së, përkatësisht me nenin 15 [Veprimtaria e Institutit] të Ligjit për Mjekësinë Ligjore. Pra, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta kanë dështuar që të përmbushin detyrën e tyre të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve nënligjore.
50. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se gjykatat e rregullta kishin përdorur të njëjtin arsyetim me rastin e hudhjes poshtë të kërkesëpadisë, refuzimit të ankesës dhe kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kur theksonin që Rregullorja e IML-së *nuk paraqet akt përfundimtar në procedurën administrative* ndaj të cilit mund të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së tij në procedurë gjyqësore ashtu siç parashihej në Ligjin për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
51. Në dritën e fakteve dhe pretendimeve të kërkesës, Gjykata konsideron se aspektet thelbësore të saj kanë të bëjnë me të drejtat e parashtruesit të kërkesës për (i) gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në ndërlidhje me (ii) të drejtën për mjete juridike efektive dhe (iii) të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.
52. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të fokusohet në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të garancive procedurale të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë"

53. Gjykata fillimisht sqaron që Neni 6 i KEDNJ-së është një *lex specialis* në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së: kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, që nënkuptojnë shtrirjen e plotë të një procedure gjyqësore, janë më të rrepta dhe i absorbojnë ato të nenit 13 (shih rastin e GJEDNJ-së: *Kudła kundër Polonisë*, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 146). Në rrethana të tilla, masat mbrojtëse të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, që nënkupton shtrirjen e plotë të një procedure gjyqësore, janë më strikte dhe i absorbojnë ato të nenit 13 (shih rastet e GJEDNJ-së: *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, nr. 7151/75 dhe 7152/75, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 88; *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 947/72; 6205/73; 7052/75; 7061/75; 7107/75; 7113/75; 7136/75, Aktgjykim i 25 marsit 1983, paragrafi 110; *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 7819/77 dhe 7878/77, Aktgjykim i 28 qershorit 1984, paragrafi 123; *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, nr. 26737/95 1997, paragrafi 41).
54. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se e drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6.1 të KEDNJ-së është qartësuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih rastin e GJEDNJ-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 4451/70, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36). Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GJEDNJ-ja ka konstatuar se "e drejta për qasje në gjykatë" është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së. (Përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta në Gjykatë dhe gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë*, nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes

përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile” para një gjykate (shih rastin e GJEDNJ-së, *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).

55. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr.47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, nr. 51357/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).
56. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.
57. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Konventa nuk synon të garantojë të drejta që janë “teorike dhe të rreme”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive”, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e GJEDNJ-së *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lartë, paragrafi 86 dhe referencat në të).
58. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kutić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lartë, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, nr. 61237/00, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, nr. 40786/98, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
59. Parimet e lartpërmendura, megjithatë, nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNJ-së e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkritazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në Gjykatë, A. E drejta dhe në qasja në Gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit ashtu që të cenohet vetë thelbi i të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lartë, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një

“qëllim legjitim” dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8225/78, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Lupeni Greek Catholic Parish kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 17101/90, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe *Marković dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

60. Në vijim, Gjykata vëren që Neni 6 i Konventës nuk garanton të drejtën e qasjes në një gjykatë me kompetencë për të shfuqizuar ose anuluar një ligj të miratuar nga ligjvënësi. Megjithatë, kur një dekret (i nxjerrë në bazë të një ligji), vendim ose masë tjetër, megjithëse nuk i drejtohet formalisht ndonjë personi fizik ose juridik, në thelb ndikon në “të drejtat civile” ose “detyrimet” e një personi të tillë ose të një grupi personash në një situatë të ngjashme, qoftë për shkak të disatributeve të veçanta për ta ose për shkak të një situatë faktike që i dallon ata nga të gjithë personat e tjerë, neni 6 paragrafi 1 mund të kërkojë që thelbi i vendimit ose masës në fjalë është në gjendje të kundërshtohet nga ai person ose grup përpara një “gjykate” që plotëson kërkesat e asaj dispozite (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Posti dhe Rahko kundër Finlandës*, nr. 27824/95, Aktgjykim i 24 shkurtit 2002, paragrafët 53-54). Kjo zbatohet *a fortiori* për një masë që zbaton legjislacionin përkatës në një rast të veçantë (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Project-Trade d.o.o. kundër Kroacisë*, nr. 1920/14, Aktgjykim i 19 nëntorit 2020, paragrafët 67-68).
61. Në rrethanat specifike të një rasti, natyra praktike dhe efektive e të drejtës së qasjes në gjykatë mund të dëmtohet, për shembull: nga kufijtë e disponueshëm të shqyrtimit gjyqësor, për shembull kur një ankesë në gjykatat administrative kundër një dekreti presidencial mund të shkaktonte vetëm një rishikim të respektimit të formaliteteve të jashtme në miratimin e dekretit, ndërsa ankesa e kërkuarit kërkonte shqyrtimin e themlit dhe të ligjshmërisë së brendshme të dekretit (shih rastin e GJEDNJ-së: *Kövesi kundër Rumanisë*, nr. 3594/19, Aktgjykim i 5 majit 2020, paragrafët 153-154, në lidhje me largimin e parakohshëm të një prokurori), dhe *a fortiori* nga mosdisponueshmëria e një rishikimi gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së: *Camelia Bogdan kundër Rumanisë*, nr. 36889/18, Aktgjykim i 20 tetorit 2020, paragrafët 76-77, në lidhje me pezullimin automatik të përkohshëm të një gjyqtari në pritje të shqyrtimit të saj ankim kundër vendimit për largimin e saj nga detyra).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

62. Gjykata rikujton se pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me mos dhënien e mbrojtjes adekuate gjyqësore nga gjykatat e rregullta, si pasojë e mos-shqyrtimit në merita të çështjes së vlerësimit të ligjshmërisë së Rregullores së IML-së, përkatësisht me nenin 15 [Veprimtaria e Institutit] të Ligjit për Mjekësinë Ligjore. Rrjedhimisht, gjykatat e rregullta kishin përdorur të njëjtin arsyetim me rastin e hudhjes poshtë të kërkesëpadisë, refuzimit të ankesës dhe kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kur theksonin që Rregullorja e IML-së *nuk paraqet akt përfundimtar në procedurën administrative* ndaj të cilit mund të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së tij në procedurë gjyqësore ashtu siç parashihet në Ligjin për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
63. Në këtë drejtim, për aq sa është i zbatueshëm neni 6 i Konventës dhe neni 31 i Kushtetutës, mbetet për t'u verifikuar nëse parashtruesi i kërkesës kishte qasje efektive në gjykatë për qëllimin e sfidimit të ligjshmërisë së Rregullores së IML-së me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore.

64. Në vijim, Gjykata rikujton praktikën e GJEDNJ-së që specifikon se Neni 6 i Konventës, përkatësisht komponenta e të drejtës së qasjes në gjykatë synon të mbrojë të drejtat që janë "*praktike dhe efektive*" në krahasim me të drejtat "*teorike*" ose "*iluzore*" (shih rastin e GJEDNJ-së: *Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, nr. 14556/89, Aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 42).
65. Nga të lartcekurat rrjedh se kur një Rregullore e Qeverisë si në rrethanat e rastit konkret, megjithëse nuk i drejtohet formalisht ndonjë personi fizik ose juridik, në thelb ndikon në "*të drejtat civile*" ose "*detyrimet*" e IML-së në një situatë të ngjashme, qoftë për shkak të disatributeve të veçanta për IML-në ose për shkak të një situatë faktike që i dallon të punësuarit në IML nga të gjithë personat e tjerë. Rrjedhimisht, neni 6 paragrafi 1 i Konventës mund të kërkojë që thelbi i Rregullores ose masës në fjalë të mund të kundërshtohet nga ai person ose grup para një "*tribunali*" që plotëson kërkesat e asaj dispozite. Ky elaborim forcohet edhe më shumë kur të kihet parasysh që Rregullorja në fjalë si në rrethanat e rastit konkret, është akt nënligjor i cili e zbaton legjislacionin përkatës, përkatësisht Ligjin për Mjekësinë Ligjore. (shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së: *Project-Trade d.o.o. kundër Kroacisë*, cituar më lartë, paragrafi 68).
66. Gjykata konstaton që qëndrimi i GJEDNJ-së në këtë aspekt i ngjan atij të miratuar në të drejtën e BE-së, ku një masë e përgjithshme sikurse një Rregullore e BE-së, në rrethana të caktuara, mund të prekë interesin individual, rrjedhimisht u mundëson personave fizik dhe juridik parashtrimin e një padie për anulim të Rregullores së BE-së përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian – GJDBE-së. (shih ish-nenin 230 të Traktatit të Komunitetit Evropian dhe nenin 263 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE); shih gjithashtu rastet e GJDBE-së: C-358/89, *Extramet Industrie SA kundër Këshillit të Komuniteteve Evropiane* [1991] ECR I-2501, paragrafi 13; Rastet e bashkuara 239 dhe 275/82 *Allied Corporation kundër Komisionit* [1984] ECR 1005, paragrafi 11, dhe në rastin 53/83 *Allied Corporation kundër Komisionit* [1985] ECR 1621, paragrafi 4)).
67. Në bazë të të lartcekurave, rezulton që Rregullorja e IML-së pa humbur karakterin e saj si akt nënligjor, rregullon të drejtat dhe detyrimet për të punësuarit në Institutin e Mjekësisë Ligjore në rrethana të caktuara, të cilët për këtë arsye kanë të drejtë, përkatësisht legjitimohen që të ngrenë padi për anulimin e kësaj Rregulloreje.
68. Në këtë drejtim, bazuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstaton që çështje e rëndësishme e cila kërkon trajtim meritore për të konstatuar çështjen e qasjes në gjykatë është edhe (i) çështja e hierarkisë së akteve juridike në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, si dhe (ii) çështja e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve juridike.

Lidhur me hierarkinë e akteve juridike në sistemin juridik të Kosovës

69. Gjykata fillimisht rikujton hierarkinë e normave juridike dhe rolin e gjykatave të rregullta në zbatimin e drejtpërdrejt të normave kushtetuese, sipas dispozitave të Kushtetutës. Lidhur me këtë Gjykata fillimisht i referohet nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] që përcakton se: "*1.Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë. [...]*".
70. Nga dispozita e lartcekur e Kushtetutës, është e qartë se Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Kosovë dhe se të gjitha normat tjera ligjore duhet të jenë në pajtueshmëri me të. Një konstatim i tillë është shprehur dhe mbështetur tashmë edhe

nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate. Më specifikisht, në këtë aspekt Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore ku kishte konstatuar se neni i lartcekur kushtetues garanton parimin e “supremacisë kushtetuese”. Sipas këtij parimi, Kushtetuta në aspekt hierarkik, qëndron në krye të piramidës dhe është burim i të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikën e Kosovës. Prandaj, piramida e akteve normative, e përcaktuar me nenin 16 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet ndërmjet normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Në këtë të fundit, “supremacia” e Kushtetutës po ashtu sigurohet përmes aplikimit të mekanizmit të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe verifikimit të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë (shih rastet e Gjykatës KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2021, paragrafi 120; KI48/18, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 182).

Lidhur me çështjen e kontrollit të Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve juridike

71. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata fillimisht rikujton se ekzistojnë praktika të ndryshme se si sistemet juridike të vendeve të tjera e rregullojnë çështjen e kontrollit kushtetues të normave juridike. Sipas një studimi të Komisionit të Venedikut, sistemet juridike të anëtarëve të Komisionit të Venedikut ndahen në grupe të caktuara kur bie fjala tek çështja e kontrollit kushtetues të normave juridike. Lidhur me përcaktimin se cili sistem i kontrollit të kushtetutshmërisë zbatohet në vende të ndryshme, studimi në fjalë thekson se klasifikimi i një sistemi juridik si “i shpërndarë” në njërën anë, apo si i “koncentruar” në anën tjetër është i vështirë dhe se, rrjedhimisht, natyra e sistemit juridik përcaktohet nga kompetencat materiale të gjykatave specifike brenda sistemit të caktuar (shih rastin e Gjykatës: KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, cituar më lartë, paragrafi 115; shih më gjerësisht lidhur me këtë aspekt, Studimin për Qasjen e Individëve në Drejtësinë Kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e 85- të Plenare 17-18 dhjetor 2010, CDL-AD(2010)039rev, faqe 12).
72. Lidhur me rolin e gjykatave të rregullta në zbatimin e drejtpërdrejt të normave kushtetuese, Gjykata rithekson praktikën e saj, sipas së cilës rezulton që gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe për më tepër obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit. Për më tepër duke pasur parasysh hierarkinë e normave juridike, gjykatat e rregullta janë të obliguara që të interpretojnë normat ligjore në harmoni me normat kushtetuese (shih rastin e Gjykatës: KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, cituar më lartë, paragrafi 124-125).
73. Prandaj, Gjykata vlerëson që e drejta dhe detyrimi për të zbatuar dhe interpretuar Kushtetutën, iu njihet të gjitha gjykatave të Republikës së Kosovës. Këto të fundit, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme si instancë më të lartë gjyqësore në nivel të Republikës, kanë për obligim të interpretojnë ligjet në harmoni me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Kushtetuta, autorizimin për të interpretuar Kushtetutën si dhe autorizimin për të interpretuar ligjet në pajtim me Kushtetutën ua njeh të gjitha gjykatave dhe autoriteteve të tjera publike në Republikën e Kosovës. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm në Republikën e Kosovës me autorizim ekskluziv kushtetues për të shfuqizuar një ligj ose normë ligjore si dhe për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me të. (shih rastin e Gjykatës: KI207/19, me parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, cituar më lartë, paragrafi 129-130).

74. Përfundimisht, për sa i përket parimit të “supremacisë kushtetuese” Gjykata rithekson që Kushtetuta qëndron në krye të piramidës dhe është burim i të gjitha ligjeve dhe akteve nënligjore në Republikës e Kosovës. Në këtë të fundit, “supremacia” e Kushtetutës po ashtu sigurohet përmes aplikimit të mekanizmit të “kontrollit të kushtetutshmërisë” së ligjeve dhe verifikimit të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë, nga ana e Gjykatës Kushtetuese.
75. Prandaj, në këndvështrimin e Gjykatës konstatohet se ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për *ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit*, përkatësisht përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për *ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës*, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë.
76. Rrjedhimisht, për sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë të akteve nënligjore normative, Kushtetuta përcakton dy lloje juridiksionesh për Gjykatën, fillimisht ushtrimin e një juridiksioni *fillestar* dhe *ekskluziv* dhe më tej ushtrimin e një juridiksioni *rishikues* dhe *subsidiar*. Në këtë drejtim, Gjykata ka juridiksion fillestar dhe ekskluziv kur shqyrton çështjet e përcaktuara me nenin 113.2 dhe 113.4 të Kushtetutës (me përjashtim të nenit 113.7), ku të gjitha rastet e listuara shqyrtohen për herë të parë nga Gjykata, e cila ka juridiksion të plotë dhe ekskluziv mbi çështjet e parashtruara.
77. Në anën tjetër, Gjykata në bazë të nenit 113.7 e vë në funksion juridiksionin e saj *rishikues* dhe *subsidiar* për të gjitha kërkesat individuale mbi respektimin e të drejtave kushtetuese, të cilat kanë si objekt kontesti edhe aktet nënligjore normative. Juridiksioni rishikues si i tillë aktivizohet pas shterimit të mjeteve juridike. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, kufiri ku fillon dhe ku mbaron juridiksioni i kontrollit gjyqësor ndaj akteve nënligjore normative dhe ku fillon juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese është i mirëpërcaktuar kur bëhet fjalë për ushtrimin e juridiksionit subsidiar (rishikues) të Gjykatës. Në këtë drejtim, pasi që parashtruesit e kërkesës të kenë marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat e rregullta, mbi bazën e padisë së tyre mbi kontestin e tyre ndaj ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ, atëherë ata legjitimohen që pretendimet për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore t’i artikulojnë në ankimin individual kushtetues.
78. Gjatë kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ, në rastin konkret të Rregullores së IML-së, gjykatat e rregullta duhet të marrin parasysh disa faktorë që përfshijnë por që nuk kufizohen në çështjet vijuese: i) nëse akti nënligjor është miratuar nga një organi i autorizuar, (ii) nëse organi miratues ka pasur bazën ligjore të nevojshme për ta miratuar atë akt nënligjor; dhe (iii) nëse përmbajtja e aktit nënligjor është brenda kufijve të përcaktuar me ligj. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh që aktet nënligjore nuk mund të zëvendësojnë ligjin ose të krijojnë rregulla të reja ligjore të karakterit të përgjithshëm që do të konkurronin me rregullat e përcaktuara me ligj. (lidhur me llojet e akteve juridike, shih karakteristikat e *akteve nënligjore normative* që ndahen akte normative të karakterit të jashtëm dhe akte normative të karakterit të brendshëm, në Opinionin [CDL-AD(2019)025] e Komisionit të Venedikut lidhur me Projekt-ligjin për aktet juridike, miratuar më 11-12 tetor 2019, paragrafët 23-31).
79. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim e vë theksin edhe tek studimi i Komisionit të Venedikut i cili vlerëson se në lidhje me llojet e normave që mund të paraqiten për vlerësim kushtetues, gjykata kushtetuese duhet të jetë e ngarkuar vetëm me verifikimin e kushtetutshmërisë së akteve ligjore, duke ua lënë në parim kontrollin e akteve nënligjore gjykatave të zakonshme, në mënyrë që të shmangin mbingarkimin e

saj. (shih studimin nr. 538/2009 [CDL-AD(2010)039rev.] mbi qasjen individuale në gjyqësinë kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venedikut në sesionin e 85-të (17-18 dhjetor 2010), paragrafi 6).

80. Prandaj, bazuar nga si më sipër, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtruesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e “*qasjes në gjykatë*” në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtruesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës.
81. Përfundimisht, Gjykata konstaton se konstatimi gjykatave të rregullta përmes vendimeve të tyre kur theksonin që Rregullorja e IML-së *nuk paraqet akt përfundimtar në procedurën administrative* ndaj të cilit mund të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së tij në procedurë gjyqësore ashtu siç parashihet në Ligjin për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, janë nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së
82. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kishte pretenduar edhe shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata konstatoi se rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës ngërthejnë elemente që ndërlidhen me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si një ndër parimet e garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe në vijim të kësaj pas elaborimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të tij dhe procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka cenuar të drejtën e tij për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, si rezultat i këtij konstatimi, Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

83. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme e cila do e pezullojë zbatimin e Rregullores së IML-së deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.
84. Për të lejuar masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 57 (5) të Rregullores së punës, duhet të konstatohet që:
- “(5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Gjykata do të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.”*
85. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti dëshmitë e nevojshme për vendosjen e masës së përkohshme, si dhe bazuar në atë që Gjykata vendosi për meritat e kërkesës dhe gjeti se në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e njëjta konstaton se vendosja e masës së përkohshme është e panevojshme.
86. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

Përfundime

87. Gjykata ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe me gjithë faktin që parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kishte pretenduar shkelje të neneve 6, 32 dhe 54 të Kushtetutës, konstatoi se rrethanat e rastit konkret ngërthejnë elemente që në mënyrë substanciale ndërlidhen me pretendim të shkeljes të së drejtës për *qasje në gjykatë*, si një nga parimet e garantuara në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjykata në vijim, dhe me qëllim të vlerësimit dhe shqyrtimit të këtij pretendimi ka aplikuar për vlerësim, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës.
88. Gjykata, pas elaborimit dhe shqyrtimit të procedurës së zhvilluar dhe arsyetimit të vendimeve të gjykatave të rregullta, konstatoi se: (i) ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për *ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit*, përkatësisht përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin ndërsa i dyti për *ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës*, përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore me Kushtetutën sipas mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë; dhe (ii) gjykatat e rregullta të sistemit juridik të Kosovës, duke mos bërë kontrollin e ligjshmërisë së Rregullores së IML-së me nenin 15 të Ligjit për Mjekësinë Ligjore, parashtruesit të kërkesës ia mohuan të drejtën e “*qasjes në gjykatë*” në kuptim të paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; dhe për pasojë pamundësuan që rasti i parashtruesve të kërkesës të shqyrtohet në meritat e kërkesës.
89. Në fund, Gjykata si rezultat i konstatimit të saj për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31, paragrafin 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së nuk e vlerësoi si të nevojshme të shqyrtojë ndaras pretendimet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës si dhe vendosi për refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme përderisa e njëjta vendosi për meritat e kërkesës dhe gjeti se në rastin konkret ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe me rregullat 57 (5) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 korrik 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË të pavlefshëm, Aktgjykimin [ARJ.nr. 115/2021] të 18 nëntorit 2021, të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktvendimin [AA.nr.651/2021] e 6 gushtit 2021, të Gjykatës së Apelit, si dhe Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- IV. TË KTHEJË, për rishqyrtim Aktvendimin [A.nr. 1430/21] e 5 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- VI. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, deri më 18 janar 2023, për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi të Gjykatës;
- VII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani